

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	222/22
Nr. i fq. / Br. st.	- 3 -
Data: / Datum:	16.9.2022
VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, e VIII-ta me radhë, mbajtur më 27 korrik 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF-së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkyetar i komunës), Drejtoret e drejtive, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

- Shqyrtimi i Draft – Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së (kryesues i komisionit për hartimin e Draft – Statutit) – tha se komisioni në përbërje të plotë e ka hartuar me sukses Draftin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe i ka respektuar të gjitha procedurat ligjore. Ai tha se kanë pranuar disa rekomandime dhe sygjerime, të cilat si komision i kemi trajtuar dhe janë përfshirë ato që kanë qenë të arsyeshme. Me përashtim të disa propozimeve që kanë ardhur në e-mail nga Jeton Salihu, të cilat bashkë me komisionin do t'i analizojmë dhe t'i përfshijmë ato që janë të arsyeshme. Komisioni në parim e ka votuar këtë draft – statut, ku të gjitha partitë politike janë pajtuar që të procedohet tutje me plotësim. Ai deklaroi se sot prej orës 10:00 ka qenë i planifikuar që të mbahet konsultimi publik për këtë çështje, por nuk ishte i pranishëm asnjë pjesëmarrës.

Ai propozoi që:

- *Neni 10 të plotësohet te lagjet urbane dhe të saktësohen në bazë të vendimit të kuvendit;*
- *Tek nen 53, të shtohet “Zyra për menaxhimin e projekteve”.*

Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së – deklaroi se po më duket e ngutshme të dërgohen në kuvend çështje që janë të rëndësishme për komunën, e sidomos për një dokument aq i rëndësishëm siç që është statuti, që konsiderohet si <kushtetutë> për komunën. Po ashtu,

nuk mu duk praktikë e mirë që vetëm një ditë para se të mbahet seanca, të mbahet mbledhja e KPF-së për këtë çështje.

Ai tha se kompetencat e drejtorive janë larguar komplet nga statuti dhe konsideroj se nuk është mirë të hiqen, sepse kryetari i komunës edhe ashtu ka mjaft kompetencia. Drejtorët e drejtorive duhet t'i kenë të përshkruara detyrat dhe përgjegjësitë, ashtu siç kanë qenë me statut të vjetër. Zyra për projekte s'po më duket e arsyeshme të futet, sepse çdo drejtori i ka organet e saja mbikëqyrëse. Emërtimet e drejtorive është mirë të rishikohen, sepse ka mundësi që disa drejtori të fuzionohet, disa të shuhën.

Ai tha se drejtoritë mos të jenë në kompetencë të kryetarit të komunës.

Ai propozoi që:

- *Drejtoria për Bujqësi të ndahet;*
- *Drejtoria për Mirëqenie Sociale të ndahet nga Shëndetësia;*
- *Drejtoria e Prokurimit duhet të shuhet, sepse është në kundërshtim me ligjin. Ajo duhet të funksionojë vetëm si zyrë.*

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se nuk kemi një raport të detajuar nga komisioni hartues i Draft – Statutit, por kemi vetëm një ekstrakt nga takimet e komisionit dhe kemi vetëm propozimet që kanë ardhur nga LDK-ja dhe LVV-ja.

Edhe unë pajtohet që kompetencat e drejtorive duhet të figurojnë në statut.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së (kryesues i komisionit për hartimin e Draft – Statutit) – ne kemi propozuar që tavani i drejtorive të jetë maksimumi 14 drejtori, pra jo vetëm për këtë mandat. Kjo nuk është obligative, sepse kryetari i komunës është ai që vendos se sa do të jetë numri, 14, 12, apo 10 drejtori. Pra, varet prej planprogramit të kryetarit të komunës se ai e mendon që të funksionojë më mirë qeverisja komunale.

Lidhur me kompetencat e drejtorive, ai tha se nuk i kemi planifikuar me statut, pasi që kemi dashur që kryetarët e komunave (jo vetëm për këtë mandat) t'i kenë duart e lira për themelimin e drejtorive dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive.

Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë (anëtar i komisionit për hartimin e Draft – Statutit) – tha se sa i përket përshkrimit të detyrave të drejtorive, ai është obligim ekskluziv i Kryetarit të komunës që me një akt të brendshëm ta përcaktojë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorive. Kurse, zvogëlimi eventual i numrit të drejtorive, nuk rrezikon asnjë shërbyses civilë nga marrëdhënia e punës, sikurse që nuk mundëson rritjen e stafit të shërbysesve civilë, nëse në të ardhmen bëhet rritja e numrit të drejtorive.

Ai propozoi që:

- *Tek neni 19, të shtohet pika 1.5 <vendimet>.*

Meliha Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – theksoi se para se të publikohet drafti final, duhet që të korrigohen edhe disa gabime teknike dhe përbajtësore.

Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës – tha se e falënderon komisionin për punën që e ka bërë për hartimin e Draft – Statutit. Ai tha se edhe nëse zvogëlohet numri i drejtorive, <Zyra për menaxhimin e projekteve> duhet patjetër të figuron, sepse krejt inxhinierët që punojnë në komunë duhet të jenë pjesë e kësaj zyre dhe që menaxhimi i projekteve të bëhet pikërisht nga kjo zyrë.

Sa i përket drejtorive, është propozimi më i miri, sepse e kam parë edhe në disa komuna që nuk i kanë emërtimet e drejtorive me statut. Ai tha se jam që të caktohet një tavan i drejtorive, por detyrat, përgjegjësitë dhe emërtimet t'i mbesin secilit kryetar që vjen dhe ai të vendos për to dhe t'i sjell në kuvend për votim.

Ai tha se nuk është qëllim i yni rritja e numrit të drejtorive, por që është mirë të ketë një kufizim.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri me këto propozime e procedoi për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës të kuvendit të komunës që do të mbahet më 28 korrik 2022.

Mbledhja përfundoi në orën **15:00**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së